



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.14/2017

Prishtinë, më 9 mars 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Miljana Nikoliq, Frashër Krasniqi, Saranda Bogujevci, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Teuta Haxhiu, Mirjeta Kalludra dhe Albulena Balaj Halimaj.

Mungoi: Mytaher Haskuka.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Visar Bovolaku-EVO/EUSR, Valbone Dermaku-OSCE, Adem gashi-US Embaassy Prishtina, Gordana Subotic- Melbourne University dhe Valbona Bytyqi-Ekonomia Online.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë.

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,
2. Organizimi i konferencës rajonale mbi pozitën e femrës në shoqëri,
3. Të ndryshme.

1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit

Kryetarja, Kryetarja konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 14 dhe 27 shkurt 2018, u miratua pa vërejtje.

2. Organizimi i konferencës rajonale mbi pozitën e femrës në shoqëri

Kryetarja, tha se për organizimin e kësaj konference kemi planifikur të ftojmë përfaqësuesit nga vendet e rajonit, kemi përgatitur një agjendë dhe se koha e mbajtjes së kësaj konference është shty për 8 -10 prill 2018. Kemi përzgjedhur tri tema për diskutim, nga një anëtarë i komisionit do të jetë referues për temën dhe nga dy anëtar tjerë do të jenë në panel për nxjerrjen e konkluzioneve.

Teuta Haxhiu-propozoi që në këtë konferencë si temë të jetë edhe çështja e të pagjeturve, pasi që 27 prilli është edhe dita e të pagjeturve në Kosovë, është me interes që të diskutohet për këtë temë dhe të nxjerrën konkluzione.

Kryetarja, tha se këtë temë e kemi përfshirë në agjendë pasi ky aktivitet është në muajin prill, dhe kemi të ftuar mysafirë nga Bosnja dhe Kroacia të cilët janë ballafaquar njëjtë sikur Kosova me këtë realitet.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se e mira e kësaj konference është se si rajon do të jemi bashkë besoj se do ti përgjigjen ftesës, temat e propozuara janë tema aktuale që ja vlen të diskutohen.

Duda Balje, propozoi që për temën e tretë, për çështjen e të pagjeturve, të ftohet edhe përfaqësuesi nga Komisioni Ndërkombëtare për Persona të Pagjetur.

Luljeta Veselaj-Gutaj, për çështjen e zbardhjes së fatit të personave të pagjetur, propozoi që përveç komisionit, ti ftojmë edhe disa familjare të personave të zhdukur femra dhe që janë kryefamiljare, të cilat kanë kaluar nëpër sfida qe 20 vite.

Lirije Kajtazi, tha se titulli i konferencës është një objektiv, vet fakti që kemi për ti ftuar vendet e rajonit është një bashkëpunim, e bashkëpunimi është në funksion të fuqizimit, e krejt temat në brendi janë në funksion të kësaj.

Teuta Haxhiu- tha se sa i përket ftesës për gratë që kanë familjarë të zhdukur e që janë kryefamiljare, është mirë që shoqatat le ti zgjedhin, ne ua caktojmë numrin por shoqatat le ti dërgojnë.

Ajo propozoi qe për temën e tretë, lidhur me fatin e personave të zhdukur të ftohen edhe përfaqësuesit e Ambasadës Britaneze sepse ata kanë ofruar shume ide për të na ndihmuar lidhur me të zhdukurit.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se më mirë të jenë prezent përfaqësuesit e shoqatave për persona të pagjetur, për arsye ti kursejmë familjarët.

Kryetarja tha se zyrtarisht do të konstatojmë shoqatat e pastaj le të vendosin ata se kë e dërgojnë në konferencë. Gjithashtu ajo njoftoj komisionin, se OSBE do të mbështesë këtë

konferencë, dhe se përkrah mendimin për të ftuar përfaqësuesit e ambasadës së Britanisë në këtë konferencë.

Kryetarja, konstatoi se kemi menduar që me datë 9 prill 2018, mysafirët e ftuar në Konferencë ti presim paradite në Kuvend, nga Komisioni FunkSIONAL.

Ajo më pas theksoi se nga një anëtar i komisionit do të jetë referues për secilën prej tri temave të konferencës, ndërsa nga dy anëtarë tjerë do të jenë në panel për nxjerrjen e konkluzioneve, sipas temave përkatëse.

Kryetarja, propozoi që për temën e parë të konferencës referuese të jetë nënkryetarja e komisionit znj. Lirije Kajtazi.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se duhet të caktohen edhe dy referuesit e tjerë nga Komisioni FunkSIONAL për dy temat tjera, por edhe emrat e anëtarëve të Komisionit në panelin për nxjerrjen e konkluzioneve për të gjitha temat. Ajo theksoi se do të ishte mirë të definojmë mbi bazën e mirëkuptimit caktimin e këtyre emrave për çështjet e lartpërmendura.

Albulena Balaj Halimaj, propozoj që të shkohet sipas subjektit politik dhe secili subjekt të jetë i përfshirë në këto tri tema.

Mirjeta Kalludra, tha se është e vështirë të përfshihet baza partiake meqë janë tri tema e i kemi 7 grupe parlamentare të përfaqësuara në komision.

Teuta Haxhiu, kërkoi mirëkuptimin e komisionit që për temën e tretë zbardhjen e fatit të personave të pagjetur ti mbetet të referoj ajo për arsye se vjen nga një rajon që është shumë i prekur me çështjen e të pagjeturve dhe se ballafaqohet me familjaret e tyre. Jam e familjarizuar me problemet dhe sfidat që ata kanë, por kjo të bëhet, nëse pajtohen anëtarët e komisionit.

Frashër Krasniqi, tha se nëse dikush ndihet i përgatitur për një temë të caktuar ashtu siç u shpreh Teuta Haxhiu, le ti lejohet të flet për atë temë, nuk është me rëndësi se i cilës parti është, me rëndësi me dal mirë në këtë konferencë.

Albulena Balaj tha se pajtohet që referuese për këto tema të jenen Lirije Kajtazi, Mexhide Mjaku Topalli dhe Teuta Haxhiu.

Kryetarja, pas diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, konstatoi se referues dhe anëtarë të panelit për nxjerrjen e konkluzioneve gjatë konferencës do të jenë anëtarët si në vijim:

Për temën e parë do të referoj, Lirije Kajtazi, ndërsa në panel do të jetë, Miljana Nikoliq dhe Luljeta Veselaj-Gutaj, për temën e dytë, referuese, do të jetë Mexhide Mjaku-Topalli, ndërsa në panel do të jenë, Albulena Balaj-Halimaj dhe Mirjeta Kalludra, për temën e tretë, referuese do të jetë Teuta Haxhiu, në panel të jenë Saranda Bogujevci dhe Frashër Krasniqi.

3. Të ndryshme.

Kryetarja njoftoi se nga studentet e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Universitetit të Prishtinës kemi pranuar një shkresë me disa kërkesa.

Albulena Balaj Halimaj- lexoj kërkesat të cilat i kanë parashtruar studentët në këtë shkresë.

Kryetarja, tha se ky peticion do të shpërndahej te gjithë anëtarëve të Komisionit dhe të shqyrtohet në Grupin Punues për shqyrtimin e Peticioneve.

Saranda Bogujevci, njoftoi anëtarët e Komisionit se javën e kaluar ka takuar përfaqësues të personave të verbër edhe ata kanë bërë një kërkesë në komision ku kanë kërkuar takim në Komision. Ajo në vazhdim tha se këtë takim e ka realizuar rastësisht.

Mirjeta Kalludra, tha se është mirë kur të organizohen aktivitete e takime të tilla në emër të Komisionit të jemi të informuar, sepse nga mediat patëm vërejtje pse si anëtarë të komisionit nuk i keni përfillur ato kërkesa të tyre. Për këtë çështje tha se nuk ka pas kërkesë paraprake në komision e as në grupin e punës për shqyrtim të peticioneve.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se formimi i grupeve punuese për monitorimin e ligjeve ka mbetur të formohet sot, dhe kërkoi që kjo të vendoset në këtë mbledhje, në mënyrë që të mos ngecim në realizimin e planit të punës.

Ajo po ashtu tha se me plan të punës do të duhej të ftojme në Komision, përfaqësues të Agjencisë për Barazi Gjinore, Koordinatorin nacional për mbrojtje nga dhuna në familje, një përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe qëllimi i ftesës është të diskutojmë konkretisht për zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit.

Ajo u interesua lidhur me përfundimin për kërkesën e Sindikatës së Pavarur lidhur me ndryshimin e Ligjit për skemat pensionale, që i kishim prezent në komision, si dhe për zbatimin e rekomandimeve nga mbikëqyrja e ligjit për persona të verbër.

Teuta Haxhiu, tha se sa i përket ligjit për persona të verbër është mirë me i vizituar ato institucione që kanë pasur obligim zbatimin e rekomandimeve të dala nga komisioni.

Kryetarja, konstatoi se në mbledhjen e radhës të ftohet Koordinatori Nacional, ABGJ përfaqësuesi i MPMS-së, për të na informuar lidhur me zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit.

Kryetarja, po ashtu pas diskutimeve lidhur me formimin e grupeve punuese për monitorimin e zbatimit të ligjeve, konstatoi se Komisioni nxori këtë:

V e n d i m

- I. Formohet grupi punues për monitorimin e Ligjit për Barazi Gjinore në këtë përbërje:

Lirije Kajtazi-Kryesuese, Duda Balje, Saranda Bogujevci, Mexhide Mjaku-Topalli, Teuta Haxhiu dhe Albulena Balaj- Halimaj, anëtare.

- II. Formohet grupi punues për monitorimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, në këtë përbërje:

Luljeta Veselaj-Gutaj, Kryesuese, Miljana Nikoliq, Frashër Krasniqi dhe Mirjeta Kalludra, anëtarë.

Kryetarja, më pas konstatoi se të hënën, me dt.12.3.2018, do të mbajmë mbledhje të komisionit, me një pikë të vetme të rendit të ditës, lidhur me privatizimin e takave në fshatin Atmaxhë, ku të ftuar në Komision do të jenë përfaqësuesit e AKP-së dhe përfaqësuesit e petitionit të fshatit Atmaxhë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje